



---

*2/41-V2*

*Rregullore*

*Maj/2020*

**RREGULLORE  
PËR STUDIME BPrAL KOLEGJI UBT  
CIKLI I PARË I STUDIMEVE**

---

**PRISHTINË, Maj 2019**

Në bazë të dispozitave respektive të LIGJIT Nr. 04/L-037 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, si dhe dispozitës së nenit 88 të Statutit të BPrAL Kolegji UBT, Presidenti me datën 15.05.2019, nxjerr këtë:

## **R R E G U L L O R E**

### **PËR STUDIME THEMELORE NË BPrAL KOLEGJI UBT**

#### **I. Dispozitat hyrëse**

##### **Neni 1.**

Më këtë Rregullore për Studime (**me tej: Rregullore**), rregullohen rregullat e studimeve ne BPrAL Kolegji UBT, llojet e studimeve, organizimi i mësimave (ligjëratave), organet për vlerësim dhe përcjellje, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentëve si dhe të drejta tjera lidhur me studimet ne UBT.

##### **Neni 2.**

Shprehjet qe përdorën në këtë rregullore, ndërsa, kanë kuptim gjinor, ka të bëjë për gjininë mashkullore dhe femërore.

#### **II. STUDIMET**

##### **Llojet dhe nivelet e studimeve**

##### **Neni 3.**

Studimet e larta arsimore në UBT organizohet dhe mbahet në nivel BAÇELLOR.

Studimet ne nivel Baçellor zgjasin:

- tri (3) vjet, dhe me përfundimin e studimeve fitohen 180 ECTC.
- katër (4) vjet, dhe me përfundimin e studimeve fitohen 240 ECTC.

Studimet organizohen dhe mbahen në përputhje me programet studimore të akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje: AKA) dhe licencuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (tutje: MASHT).

Në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Kosovës, si dhe institucione analogë të jashtme, organizohen dhe mbahen edhe studime të përbashkëta, të dyfishta dhe formave të tjera konformë ligjit.

## **Struktura e programeve**

### **Neni 4.**

Programet e studimit që çojnë drejt marrjes së diplomës/certifikatës janë modulare, të shprehura përmes grumbullimit të kredive sipas Sistemit Evropian për Transferim të Kredive (ECTS): për të fituar një diplomë universitare nevojiten 240 kredi/ose 180 kredi, në varësi të programit të regjistrimit në fillim të studimeve. Lloji i kredive dhe mënyra se si grumbullohen varet nga planprogramet e publikuara. Është kërkesë minimale që për gjitha kualifikimet në ciklin e parë ose poshtë këtij niveli, një e treta e kredive totale të jetë fituar nga studimet në Arsimin e Lartë.

Moduli themelor i studimit është lënda semestrale me kreditë e ECTS të bashkangjitura në planprogramin e miratuar të UBT-së. Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të lëndës, siç është përshkruar edhe në këtë Rregullore. Për pranim në lëndët speciale semestrale të cilat janë pjesë e programit të diplomimit do të duhet të kalohet parakushti në nivel të caktuar për një ose më shumë lëndë të tilla, ndërsa parakushti nuk do të konsiderohet në të njëjtën mënyrë pas kalimit të tre viteve kalendarike pas përfundimit me sukses të këtyre lëndëve, përveç nëse Këshilli i Fakultetit që është kompetent për këtë nuk përcakton ndonjë periudhë tjetër. Tërheqja nga lënda lejohet deri në datën e dorëzimit të pjesës së fundit të punës së vlerësuar ose para provimeve, cila të jetë më e fundit.

## **Regjistrimi ne studime**

### **Neni 5.**

Studentët pranohen në programet e studimit në bazë të konkursit të miratuar nga Këshilli Akademik. Gjithashtu mund të specifikohen edhe kërkesa të tjera për pranim.

Regjistrimi bëhet duke realizuar pagesën e shkollimit të aprovuar nga ose në emër të Bordit të UBT-së, si dhe sigurimit të dokumenteve për regjistrim në përputje me kërkesat e përcaktuara në konkurs.

Pas regjistrimit të parë, por para regjistrimit të vitit të dytë të studimeve, studentët mund të transferohen nga një fakultet në tjetrin, në varësi prej afërsisë së programit të studimeve, por vetëm me aprovim të Komisionit për transfere në fakultetin përkatës, i cili duhet të sigurojë nëse studentët i përmbushin kërkesat për pranim në fakultetin e ri.

## **Dokumentet studentore**

### **Neni 6.**

Me rastin e regjistrimit të parë të studimeve, studenti pajiset me dokumentacion studentor me të cilët rregullohet përmbajtja, përpunimi, lëshimi, shfrytëzimi, forma dhe anulimi i dokumenteve studimore.

Dokumenti studentor është dokument publik me të cilin dëshmohet statusi i studentit.

## **III. ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E STUDIMEVE**

### **Programi studimor dhe ndryshimet e tyre**

#### **Neni 7.**

Studimet akademike organizohen dhe mbahen sipas programeve studimore të akredituara dhe licencuara.

Përmbajtja e programeve studimore saktësohen nga Këshilli Akademik, sipas rekomandimit të Këshillit të Fakultetit dhe aprovimit nga AKA dhe MASHT.

Procedura e ndryshimeve dhe plotësimeve të programeve studimore përkufizohen me rregullore të posaçme.

### **Mbajtja e planit dhe programit të studimeve**

#### **Neni 8.**

Studimet zbatohen sipas Planit dhe programit të studimeve, të cilin çdo vit kalendarik e miraton në pajtim me akreditimin e tij.

Plani dhe programi i studimeve publikohet ne platformat zyrtare të “UBT-së” para fillimit të vitit akademik për vitin vijues, përfshirë këtu edhe përmbajtjen e thukët të ligjëratave dhe format tjera mësimore, si dhe tekstin e ligjëratave dhe formave tjera në raste të përjashtimeve të pamundësisë se sigurimit të literaturës gjegjëse.

Në përputhje me planin dhe programin e studimeve bartësit e lëndëve përpilojnë planin e realizimit të lëndës gjegjëse.

Këshilli i Fakultetit krijonë Komisionin për Kompatibilitetin e Sillabuseve i cili vlerëson përmbajtjen e planit të lëndëve që do të ligjërohen, dhe në përputhje me planin dhe programin e akredituar i rekomandon të gjeturat bartësit të lëndës përmesë përgjegjësit të fakultetit.

Përgjegjësi i fakultetit në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit paraqet raportin e kompatibilitetit të Sillabuseve për miratim të cilat duhet të aprovohen para fillimit të semestrit.

Mësimdhënësi është i obliguar që në orën e parë të ligjëratave studentëve t'ua shpalos Planin e lëndës përkatëse.

#### **IV. PROCESI MËSIMOR (LIGJËRATA)**

##### **Organizimi i ligjëratës**

###### **Neni 9.**

Mësimi (ligjërata) organizohen dhe mbahen në semestra në përputhje me programet studimore.

Mësimi (ligjërata) mund të mbahet dhe në formën rrethit virtual për mësim.

Mësimdhënësi në baza ditorë evidenton ligjëratën e mbajtur, si dhe raportimin adekuat personave përgjegjës çdo fund semestër.

Me regjistrimin në degën e caktuar akademike studenti merr detyrimin paraparë më Plan Akademik Arsimor.

##### **Kalendari akademik**

###### **Neni 10.**

Kalendarin Akademik e miraton Këshilli Drejtues i “UBT-se” deri me datën 31 Tetor, si dhe e publikon në platformat elektronike të UBT-së.

Kalendari Akademik përmban kornizën përcaktuese të fillimit dhe përfundimit të vitit kalendarik akademik, terminin e mbajtjes së ligjëratave, festat shtetërore, aktivitetet dhe ngjarjet e tjera brenda UBT-së, si dhe të ngjashme konformë Programit Akademik dhe Ligjit.

## **Orari i ligjeratave**

### **Neni 11.**

Orari i ligjeratave draftohet nga përgjegjësi i fakultetit në bashkëpunim me njësit e tjera një muaj para fillimit të semestrit.

Koordinimi i orarit të ligjeratave dhe ushtrimeve me njësit e tjera realizohet përmesë Drejtorisë për Çështje Akadematike në UBT.

Drafti final i orarit të ligjeratave dhe ushtrimeve aprovohet nga Këshilli Akadematik në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Fakultetit.

Orari i aprovuar dy javë para fillimit të procesit mësimor publikohet për studentë dhe mësimdhënës.

## **Format e ligjëratave**

### **Neni 12.**

Mësimi mbahet në formën e ligjëratave, moduleve, seminareve, ushtrimeve, praktikave në teren, ligjëratat konsultative, praktikave profesionale pedagogjike dhe forma tjera mësimor.

Të gjitha format e ligjëratave organizohen dhe mbahen në pajtim me Programin e studimeve të aprovuar nga Këshilli Akadematik.

## **Përshkrimi i formës së ligjërates**

### **Neni 13.**

Studentet në ligjërata trajtonë dhe zhvillojnë pjesën teorike të lëndës përkatëse në përputhje me programin e studimeve.

Ushtrimet organizohen dhe mbahen me qëllim arritjeje të dijes praktike dhe shkathtësive.

Ushtrimet mund të mbahen edhe jashtë hapësirave të “UBT-se” në përputhje me dakordimet adekuate me institucionet tjera akademike dhe jo akademike.

Praktika e terrenit i fut studentet në punën praktike dhe ekzekutohen në pajtim me planet studimore akademike.

Punën praktike në terren e udhëheq mësimitdhënësi i lëndës praktike dhe mentorit të autorizuar.

Konsultimet i mbajnë mësimitdhënësit si dhe bashkëpunëtorët që marrin pjesë në proces akademik. Numri i orëve konsultative në parametra javor i cakton Këshilli i Fakultetit dhe i njëjti publikohet.

## **V. MBAJTJA E PROVIMEVE**

### **Mënyra e dhënies së provimeve**

#### **Neni 14.**

Mënyra e dhënies së provimeve studentore rregullohet me plan dhe program të studimeve në përputhje me Stutin e UBT-së.

Provimet studentët i përfundojnë tek profesori i lëndës i caktuar me Program të studimeve.

Në rast të pengesës së mësimitdhënësit të lëndës, Këshilli i Fakultetit mundet mbajtjen e provimeve t'ia besoj arsimtarit tjetër të fushës së njëjtë.

Në rastet tjera të arsyeshme Rektori mund të angazhoi arsimtar tjetër që të mbaj provimin.

### **Afatet e Provimeve**

#### **Neni 15.**

Provimet mbahen në afate të rregullta dhe afate plotësuese, kurse terminin për mbajtjen e provimeve e cakton Këshilli Akademik. Ndërmjet dy (2) afateve të provimeve duhet të kenë distancë së paku dy (2) javë periudhë kohore.

#### **Afatet e rregullta të provimeve janë:**

- afati dimëror i provimeve,
- afati veror i provimeve,
- afati vjeshtor i provimeve.

Afatet plotësuese në UBT caktohen nga Këshilli Akademik në përputhje me rekomandimin e Këshillit të Fakulteteve.

## **Paraqitja e provimeve**

### **Neni 16.**

Studenti paraqitjen e provimit e bënë me se voni tri (3) ditë para mbajtjes se provimit.

Paraqitja e provimit behet përmes sistemit SMIS.

## **Shtyrja e provimit**

### **Neni 17.**

Studenti ka të drejtën e tërheqjes së provimit me se voni 24 orë para mbajtjes se provimit.

Nëse studenti nuk i është nënshtruar dhënies së provimit, ndërsa, nuk ka bërë ç lajmërimin e dhënies së provimit nga alinetë paraprake, provimi i paraqitur numërohet në numrin e përgjithshëm të daljes në provime nga departamenti i njëjtë, në pajtim me këtë Rregullore, dhe ne Listën e Provimeve shënohet “Nuk ka marr pjesë”.

## **Rezultatet e provimeve**

### **Neni 18.**

Mësimdhënësi është i obliguar që te publikoi rezultatet e provimeve me shkrim, nga dita e mbajtjes se provimeve sipas kësaj dinamike:

<b>Nr.</b>	<b>Numri istudentëve të nënshtruar provimit</b>	<b>Ditët kalendarike për dorëzimin e rezultateve</b>
<b>1</b>	1 - 50	7
<b>2</b>	51 - 100	10
<b>3</b>	101 - 150	15
<b>4</b>	151 - 200	20
<b>5</b>	200 +	30

Me kërkesën e studentit arsimtari është i detyruar ti japi studentit në shikim vlerësimin e provimit me shkrim.

Provimi me gojë dhe provimi praktik janë publik dhe mbahen ne prezencën e se paku edhe të një personi.

Mësimdhënësi është i obliguar që sipas afatit të theksuar me lartë të vendos notat në SMIS, si dhe brenda të njëjtës ditë të dorëzojë 3 kopje origjinale tek Dekani i fakultetit gjegjës.

Dekani nënshkruan pranimin e rezultateve, pas verifikimit të saktësisë së plotësimit të formularit për vlerësim të studentëve dhe afatit të dorëzimit të rezultateve të provimit.

**Rezultatet e provimeve shperndahen, sipas këtij destinimi:**



- 1 – kopje origjinale mbetet në arkivën e fakultetit;
- 1 – kopje origjinale mbetet tek profesori i lëndës;
- 1 – kopje origjinale dorëzohet në shrbimin studentor për arkivim.

Të gjitha këto veprime dorëzohen brenda ditës me letër përcjellëse, përmesë protokollit të brendshëm.

### **Ruajtja e provimeve të shkruara**

#### **Neni 19.**

Mësimdhënësi është i detyruar që të ruaj testet e provimeve, respektivisht, detyrat e shkruara nga provimi, me se paku një (1) vit nga mbarimi i vitit akademik në të cilin provimi është dhënë.

### **Lista e provimit**

#### **Neni 20.**

Evidenca e dhënies së provimit udhëhiqet në nivel të administratës së “UBT-se” dhe të njëjtatë ruhen nga ana e UBT-së në arkiven e përgjithshme.

### **Komisioni për provim**

#### **Neni 21.**

Studenti pas afatit të tretë i nënshtrohet provimit me Komision të cilin e emëron Dekani i njësisë akademike.

Komisioni për provim përbëhet nga Kryetari dhe dy (2) anëtarëve. Mësimdhënësi i lëndës tek i cili studenti nuk ka mundur të japë provimin, nuk mund të jetë Kryetar i Komisionit për provim.

Komisioni vendos me vota shumicë.

Komisioni mbanë procesverbal gjatë dhënies së provimit.

Vendimi i Komisionit është përfundimtarë. Notën nga provimi para Komisionit e shënon Kryetari i Komisionit.

Në notën e dhënë nga Komisioni nuk mund të parashtrahet ankesë.

Nëse studenti para Komisionit dështon në dhënien e provimit, i njëjti detyrohet që të ridëgjojë lëndën.

## **Neni 22.**

Studenti i cili nuk i plotëson detyrimet kundrejt lëndës gjatë viti akademik të regjistruar, është i obliguar që të ridëgjojë lëndën.

## **VI. NOTIMI**

### **Forma e notimit**

#### **Neni 23.**

Puna e studentit në program të studimeve përcjellët, vlerësohet dhe notohet gjatë ligjëratave, respektivisht, gjatë zgjatjes së ligjëratave dhe në provim, në pajtueshmëri me programet studimore dhe sillabusin e lëndës gjegjëse.

Procedura e vlerësimit si dhe kushtet themelore që studentit duhet plotësuar që të fitojë të drejtën në notë caktohen në sillabusin e lëndës.

Vlerësimi dhe notimi i studentëve realizohet me ECTS, vlerësimit dhe poentimit nacional dhe përqindjes së suksesit.

Me rastin e vlerësimit dhe notimit të punës së studentit me invaliditet, dispozitat e kësaj Rregulloreje mund të adoptohen atyre studentëve.

### **Përqindjet e notimit**

#### **Neni 24.**

Suksesi i studentit për secilin njësi akademike shprehet në formulën e vlerësimit në përqindje nga 0 deri 100%, me ç'rast nota kalimtare duhet të ketë 51% deri 100%, konkretisht me nota prej 6 deri 10 është kaluese.

Përcjellja dhe notimi i studentit për secilin lëndë realizohet në formë që gjatë ligjëratave (100% pjesëmarrje në notim total) ashtu që vlerësimi i pjesëmarrjes së aktivitetit të studentit në përqindje të notimit merret në atë mënyrë të definuar sipas sillabusit të lëndës. Në këtë rast studentit mund të marri notën në bazë të poenëve dhe kushteve mbledhur gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe aktiviteteve të tjera të parapara me sillabusin e lëndës.

Provimi mund të jetë me shkrim, me gojë, praktik ose i kombinuar në pajtim me programin studimor:

- provimi me shkrim mund të zgjasë nga 30 minutë deri 180 minutë,
- provimi me gojë për kandidat nuk guxon të zgjasë me shumë se 30 minuta,
- provimi praktik për kandidat nuk guxon të zgjasë me shumë se 70 minuta,
- provimi i kombinuar nuk guxon të zgjasë me gjatë se koha paraparë për provim me shkrim, provim me gojë ose provim praktik.

### **Vlerësimi numerik i studentit**

#### **Neni 25.**

Vlerësimi numerik (lartësia nacionale) bëhet mbi bazën të rezultatit të arritur përfundimtar, respektivisht, mbledhjes së notave realizuar gjatë ligjëratës ose notimit gjatë ligjëratës, si dhe notimit në provimin përfundimtar, si dhe aktiviteteve tjera, si me poshtë:

- nota 10 nga 90.00 deri 100% vlerësimi;
- nota 9 nga 80.00 deri 89.99% vlerësimi;
- nota 8 nga 70.00 deri 79.99% vlerësimi;
- nota 7 nga 60.00 deri 69.99% vlerësimi;
- nota 6 nga 50.00 deri 69.99% vlerësimi;
- nota 5 nga 0 deri 49.99% vlerësimi;

Për lëndët për të cilin sipas programit studimor perceptohet të përshkruhet me notë të shkruar, mësimdhënësi jep notën “mjaftueshëm” studentit i cili realizon 50.00% e me shumë të detyrimeve në përputhje me sillabusin e lëndës dhe programin e studimeve.

Në dokumentin studimor shënohet nota, nënshkrimi i mësimdhënësit të lëndës së caktuar, data e dhënies së provimit, vlerësimi i studentit.

### **Lënda materiale në provim**

#### **Neni 26.**

Në provim pyetjet duhet kufizuar se bëri në materien brenda literaturës dhe ligjëratës në pajtim me sillabusin e lëndës gjegjëse, ndërsa, përmbajtja dhe ndërlikueshmëria e provimit duhet të jetë e unifikuar për të gjithë studentet që i nënshtrohen provimit.

Nuk lejohet përsëritja e të njëjtit pyetsor në afatet pasuese për të njëjtit student.

### **Rregullat e sjelljes në pjesën praktike të provimit**

#### **Neni 27.**

Gjatë kohëzgjatjes së provimit pritet sjellje e studentëve ne provim ne pajtim me rregullat e sjelljeve paraparë me RREGULLORE MBI PËRGJEGJËSIT E STUDENTËVE, dhe kështu nuk është e lejuar:

- **prezantimit të pjesës praktike të provimit pa konsultim me mentorin,**
- **prezantimit të pjesës praktike të provimit pa përgatitje adekuate paraprake,**
- **gjatë mbajtjes praktike të provimit të sjellët dhe zbatoj rregullat në zgjedhjen e detyrave.**

Ne te gjitha rastet e sipërme mësimdhënësi i lëndës provimin nuk do të shqyrtoi, studenti bie ne provim, ndërsa, mësimdhënësi lajmëron rastin organit nënkomisionit të ankesave të njësisë akademike.

### **Kundërshtimi ne notë**

#### **Neni 28.**

Mësimdhënësi duhet studentit t'ia arsyetoi notën përfundimtare.

Studenti i cili është vlerësuar negativisht në provim ose është i pakënaqur me vlerësimin, gëzon të drejtën e parashtrimit të kundërshtimit në notim. Kundërshtimi i paraqitet Dekanit të Fakultetit në afatin dy (48 orë) ditor pas njoftimit dhe/apo publikimit të notës. Kundërshtimi duhet arsyetuar mirë.

Nëse kundërshtimi në notë është i bazuar, Dekani i Fakultetit do miratoi vendim me të cilin lejon përsëritjen e provimit, emëron Komisionin e Vlerësimit dhe cakton kohën për mbajtjen e provimit të përsëritur.

Komisioni Vlerësues e përbëjnë: Kryetari dhe dy (2) anëtar, njëri prej të cileve duhet të jetë i fushës së ngusht. Mësimdhënësi i lëndës i cili atakohet me kundërshtim nuk mund të jetë Kryetar i Komisionit Vlerësues.

Kundër notimit të Komisionin Vlerësues për provim të përsëritur nuk lejohet parashtrimi i mëtejme i kundërshtimit.

### **Përsëritja e provimit**

#### **Neni 29.**

Provimi i serishëm organizohet me se voni tri (3) ditë nga data e vlerësimit të kundërshtimit të bazuar.

Provimi me shkrim ose pjesë e provimit me shkrim nuk përsëritet para Komisionit Vlerësues, veç se i njëjti përsëri shikohet dhe kontrollohet si dhe vlerësohet.

Ne bazë të notave të propozuara nga të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues, Kryetari i Komisionit Vlerësues mbyllë notën përfundimtare dhe nëse nota është pozitive, Kryetari i Komisionit notën e regjistron ne dokumentin adekuat. Nota përfundimtare nuk mund të jetë pozitive nëse dy (2) anëtar të Komisionit Vlerësues kanë propozuar notë negative.

Ne vendimin e Komisionit Vlerësues nuk mund të paraqitet kundërshtim të mëtejshëm.

## **VII. STATUSI I STUDENTIT**

### **Fitimi i statusit të studentit**

#### **Neni 30.**

Statutin studentit e arrin me regjistrimin në “UBT”.

Statusi i studentit dëshmohet me dokument studentit.

### **Studentet e rregullt dhe studentet me korrespondencë**

#### **Neni 31.**

Studenti mund të jetë i rregullt dhe me korrespondencë.

Student i rregullt është student që studion sipas planit të programeve që bazohen në mbajtjen (vijimin) e ligjëratave, ushtrimeve dhe aktiviteteve tjera me orar të plotë.

Student me korrespondencë është student i cili me planin e programit ligjëratatë i vijon në orar dhe terminë të përshtatshëm në pajtim me planin dhe programin e studimeve.

Studenti mund të ndërroi statusin e tij nga student i rregullt në student me korrespondencë dhe anasjelltas, me paraqitjen e lutjes Shërbimit Studentor të njësisë akademike dhe aprovimit të saj nga ana e Dekanit.

### **Zgjatja e statusit të studentit**

#### **Neni 32.**

Statusi i studentit zgjatë me së shumti dyfishin e kohës nga koha e paraparë për kohëzgjatje studimesh. Në kohën e zgjatjes së studimeve nuk llogaritet koha e statusit të ngrirë të studimeve.

Në raste të jashtëzakonshme, Rektori ose personi i autorizuar nga Rektori mund ti lejoj studentëve të caktuar afat me te gjatë për përfundim të studimeve, por i njëjti duhet të paraqet kërkesë të argumentuar.

### **Ndërprerja e statusit të studentit**

#### **Neni 33.**

##### **Personi humb statusin e studentit:**

1. Kur përfundon studimet.
2. Kur ç ‘regjistrohet nga UBT.
3. Kur nuk përfundon studimet n ‘afat paraparë i studimeve sipas planit dhe programit të studimeve dhe kësaj Rregullore.
4. Kur nuk arrin të përmbush detyrimet kontraktuale të studimeve.
5. Kur largohet nga studimet për shkaqe paraparë me Ligj dhe akte normative të “UBT-se”.

### **Ç ‘regjistrimi nga UBT**

#### **Neni 34.**

Studenti gëzon te drejtën e ç ‘regjistrimit nga UBT ne bazë të kërkesës së paraqitur ne formë të shkruar qe i paraqitet Shërbimi për Çështje të Studentëve. Mbi ç ‘regjistrimin e studentit personi i autorizuar nga Rektori bie aktvendim të posaçëm.

Mbi ç ‘regjistrimin e studentit mbahet shënim i veçantë, duke nënshkruar dhe vulosur të njëjtin, si dhe dorëzimin e aktit mbi ç ‘regjistrimin studentit të ç ‘regjistruar nga UBT.

Studenti nuk mund të ç ‘regjistrohet nga UBT deri sa te mos përmbushi të gjitha detyrimet kundrejt “UBT-se”, respektivisht, deri sa nga Shërbimi për Çështje të Studentëve të sigurohet vërtetimi adekuat mbi ç ‘regjistrimin ne libër përkatës.

Në rast se studentit dëshiron të tërhiqet nga studimet në UBT, së pari do të duhet të:

- Pastrojë llogaritë e pagesave me Departamentin e financave konformë detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e studimeve;
- Kontrollonjë me bibliotekarin nëse kanë ndonjë libër për të kthyer;

- Plotësojnë formularin e marrë nga Zyre Regjistrimit me deklaratë se dëshirojnë të tërhiqen nga UBT;
- T'i mbledhin dokumentet dhe të dorëzojnë kartën e identifikimit.

### **Neni 35**

#### **Riregjistrimi bëhet sipas procedurës në vijim:**

Studenti gëzon të drejtën e regjistrimit të serishëm të studimeve në studimet e ndërprera me herët (vazhdim studimeve).

Studenti nga alineja paraprahe të këtij neni, regjistron vazhdimin e studimeve sipas kriterëve në fuqi të programit studimor për vitin akademik kalendarik që regjistron vazhdimin, nën mundësin e pranimit të provimeve të dhëna.

**KËRKESA** për vazhdim studimeve me se vonit deri me datën 30 Shtator për vitin akademik vijues.

UBT do të përcaktoj kushtet për vazhdim studimesh me akt të posaçëm.

Vendimin lidhur me **KËRKESËN** e studentit për vazhdim studimesh të ndërprera, e nxjerrë personi i autorizuar nga Rektori.

- a. mbushet kërkesa për riregjistrim (që merret në zyrën për çështje studentore) dhe e njëjtë dorëzohet në Shërbimin Studentor. Kërkesës studentit duhet t'ia bashkangjesë edhe transkriptën e notave;
- b. Studenti njoftohet për kushtet e riregjistrimit dhe detyrimet sipas planit dhe programit të studimeve nga ana e Prodekanit/personit përgjegjës të Fakultetit
- c. Shërbimi Studentor në bashkpunim me Zyrën e Financave e njoftojnë studentin me detyrimet financiare të cilat studentit duhet të përmbush për arsye të riregjistrimit të vitit akademik.
- d. dokumentacioni i kompletuar arkivohet në dosjen e studentit;

## **VIII. TË DREJTA DHE DETYRIMET E STUDENTËVE**

### **Neni 36.**

**Studenti gëzon të drejtën:**

1. Vijim ligjëratash përcaktuar me Program Studimor.

2. Dhënie provimesh ne mënyrë dhe brenda afateve përcaktuar nga UBT, sipas Programit të Studimeve.
3. Regjistrim ne vitin me të lartë mbi bazën e përmbushjes se kushteve dhe kritereve saktësuar me program Studimor.
4. Përfundimin e studimeve sipas programit Studimor ne pajtueshmëri me Ligjin, Statutin dhe këtë Rregullore.
5. Pjesëmarrje ne punën e Tubimeve Studentore dhe organizimeve tjera studimore.
6. Pjesëmarrje në punën dhe vendimmarrjen ne organet e “UBT-se”, këshillave dhe organeve tjera shkencore, hulumtuese, kulturore dhe sportive etj., ne pajtim me Ligjin, Statut dhe akteve tjera normative të “UBT-se”.
7. Studime kualitative dhe proces edukativo arsimor ne pajtim me programet arsimore si dhe të drejtën e deklarimit kundrejt kualitetit të ligjëratave dhe arsimtarëve.
8. Ankimimit në rast të shkeljes se ndonjë nga te drejtat e tij në mënyrë paraparë me Ligj, Statut dhe akte normative të “UBT-se”.
9. Të drejta tjera paraparë me Ligj, Statut dhe akte tjera normative të UBT-se”.

Studenti është i detyruar qe të nderoj dhe respektoj e sjellët konformë rregullativës studentore dhe akteve të përgjithshme normative të “UBT-se”, si dhe detyrimeve tjera në UBT.

Të drejta e ndërsjellë të te drejtave dhe detyrimeve të studentit dhe “UBT-se” përcaktohen me KONTRATË MBI STUDIMET i cili lidhet dhe nënshkruhet me rastin e regjistrimit ne vitin e I-re të studimeve.

Përgjegjësitë – si dhe të drejta dhe detyrimet e studentit, me gjerësisht rregullohen me akt të posaçëm normativ të “UBT-se”.

## **Pushimi**

### **Neni 37.**

#### **E drejta ne pushim të studimeve studentit gëzon:**

- gjatë kohëzgjatjes se lehonisë,
- gjatë kohëzgjatjes se pushimeve prindorë deri sa fëmija ta mbushi një vit jete, respektivisht, deri ne përfundim te 1 viti akademik derisa fëmija mbush 1 vjet,
- gjatë kohëzgjatjes se pushimit mjekësor me të gjatë,



- raste tjera te arsyeshme ndërprerjeje te studimeve.

Ne rast pengese dhe përmbushjeje te detyrimeve studentore për shkak të sëmundjes arsyetuar me dokumentacion adekuat mjekësor, studentit do ti miratohet kërkesa për pushim studimesh për vit adekuat kalendarik, konkretisht deri në eliminimin e rrethanave të cilat kanë penguar vazhdimin e studimeve.

Me kërkesë të arsyetuar dhe argumentuar mirë – si dhe me prova te nevojshme materiale bashkëngjitur kërkesës, studentit mund ti lejohet pushimi i studimeve edhe për shkaqe tjera nga përgjegjësi i UBT-së.

Kërkesa duhet parashtruar në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes ne dijeni për shkaqet dhe arsytet e bazuara për lejim pushimi studimesh, ndërsa, Përgjegjësi duhet vendosur rastin me nxjerrje të vendimit të posaçëm brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes se kërkesës.

Gjatë kohës së pushimit të studimeve studenti nuk gëzon të drejtën e nënshtrimit të provimeve, si dhe përvetësimit të shërbimeve të UBT-së.

Koha e pushimit të studimeve nuk llogaritet ne kohën paraparë për studime.

### **Shpenzimet e studimeve**

#### **Neni 38.**

Shpenzimet e studimeve bien në ngarkesë dhe barrë të studentit, konformë akteve normative të “UBT-se”.

### **Progresi Akademik**

#### **Neni 39.**

Për të kaluar prej një viti në vitin e ardhshëm akademik studentët duhet të plotësojnë këto kushte:

- nga viti i I (parë) i studimeve në vitin e II (dytë) të studimeve, studenti duhet të ketë akumuluar së paku 42 kredi gjatë studimeve në vitin përkatës akademik ;
- nga viti i II (dytë) i studimeve në vitin e III (tretë) të studimeve, studenti duhet të ketë akumuluar së paku 102 kredi gjatë studimeve në vitin përkatës akademik ;
- nga viti i III (tretë) i studimeve në vitin e IV (katërt) të studimeve, studenti duhet të ketë akumuluar së paku 162 kredi gjatë studimeve në vitin përkatës akademik;

- studentët të cilët deri në fund të vitit akademik nuk arrijnë të akumulojnë së paku 10% të kredive të vitit përkatës do të humbin statusin e studentit në UBT.

Studentët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e lartpërmendura do të duhet të reregjistrojnë të njëjtin vit në vitin e ardhshëm akademik.

### **Përcaktimin e mënyrës së pagesave të shkollimit**

#### **Pagesat për studime**

##### **Neni 40.**

Studentët paguajnë kompensimin për studime në shumë të caktuar për programin përkatës të studimeve dhe për vitin përkatës së studimeve. Shumat caktohen nga organet e UBT-së në konkursin për regjistrim të studentëve.

Studentët janë të detyruar të likuidojnë pagesat përkatëse në përputhje me kontratën e studimeve në bazë të vitit akademik.

Studentët janë të obliguar që për regjistrimin në studime vitit akademik të bëjnë pagesën përkatëse, ndërsa me rastin e regjistrimit në studime të realizojnë pagesën e dy kësteve të para, ndërsa muajit e tjerë ndahen në këste të barabarta të pagesave, duke zbritur këto dy këste të pagesave në dy muajit e fundit të vitit gjegjës akademik.

Pagesën, studenti/ja është i obliguar ta bëjë në xhirollogarinë e UBT-së, më së largu deri me datën 05 të muajit vijues.

Studentët janë të obliguar që shumën e pagesës së caktuar me kontratë të paguajnë në tërësi edhe nëse me dëshirën-fajin e tij largohet nga UBT para përfundimit të vitit akademik.

Studentët lirohen nga pagesa në rastet e jashtëzakonshme (fuqisë madhore), për çka Organi kompetent i UBT-së mund ta lirojë nga pagesa për pjesën e mbetur.

Për shërbimet materiale të ofruara, shpenzimet duhet t'i mbulojë vetë studenti/ja, si dhe shpenzimet e pjesëmarrjes në ndonjë ekskursion, mbrëmje, qëndrim jashtë vendit etj, vetëm nëse diçka të ngjashme ofron falas nga UBT.

Në të gjitha rastet kur studenti nuk e likuidon detyrimin në afatin e përcaktuar pason sanksioni prej 0,2% kamatë ditore për çdo dite të vonuar, por jo më gjatë se 60 ditë nga dita e skadimit të afatit.

Nëse studenti nuk e kryen pagesën, studentit i ngrihet (bllokohet), statusi i studentit. Ngrirja e statusit nënkupton bllokimin e evidentimit të notave, bllokimin e certifikatave-transkripteve, diplomës, si dhe shërbimeve të tjera brenda UBT-së.

Në raste përjashtimore, për arsye objektive, studenti i drejtohet Komisionit përkatës të formuar prej Rektoratit enkas për zbatimin e kësaj rregullore, me kërkesë për lehtësime në vonesat eventuale. Arsye objektive nuk konsiderohet gjendja e vështirë materiale e financiare e studentit.

### **Kthimi i pagesave të studentëve për studime**

#### **Neni 41.**

Studentëve nuk u kthehen pagesat e bëra për studime në UBT.

Studenti i cili realizon pagesën dhe kërkonë që të njëjtat të barten tek anëtari i ngushtë i familjes (vëllait ose motrës) të njëjtat nuk mund të barten ose të transferohen tek personat e tjerë.

### **Zbatimi i rregullave**

#### **Neni 42**

Shërbimi për financa në UBT dhe Shërbimi i Studentëve janë përgjegjës për zbatimin e përpiktë të këtyre rregullave në të kundërtën do të sanksionohen në vlerë të trefishtë të shumës për të cilën është dëmtuar UBT.

### **Bursat studentore**

#### **Neni 43.**

Njohja e Rektorit të “UBT-se” është pranim studentit me të mirë për suksesin e arritur ne vitin paraprak të studimeve akademike.

Shpërblimi ndahet një herë ne vjet studentëve të te gjithave njësize akademike (fakulteteve) në bazë të aktit të posaçëm normativ.

Shpërblimet (dhuratat) i ndan Rektori i “UBT-se” çdo vit.

Dhuratat dhe mirënjohjet dorëzohen në mënyrë solemne në një tubim të përbashkët të “UBT-se”, zakonisht me rastin e festimit të datës së themelimit të “UBT-se”.

Kriteret për bursë përcaktohen me vendim të veçant për çdo vit akademik, dhe kushtet themelore janë:

- Kryerja e provimeve të vitit akademik gjegjësisht në afatet e rregullta brenda të njëjtit vit akademik;
- Nota mesatare 9.0 e sipër në tërësi;
- Të ketë të përfunduara me rregull pagesat financiare të studimeve;
- Të mos është i ndëshkuar brenda institucionit;

Bursa vlenë për studeentët të cilit e kanë të përfunduar së paku një vit akademik në UBT.

Bursa përlllogaritet nga pagesa bazë e studimeve në fund të vitit financiar, pasi që studenti t'i ketë kryer pagesat e kësteve të arritura, ndërsa pjesa e bursës zbritet në këstet e fundit të pagesës së vitit financiar.

## **Mobiliteti**

### **Neni 44.**

Studenti në përputhje me kriteret e transferit mund të realizojë transferin prej një programi të studimeve në programin e përafërt të studimeve, si dhe prej një institucioni në institucionin tjetër, duke u çregjistruar nga programi i studimeve paraprakë.

Transferi i studentëve realizohet në afatet e caktuara kohore nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa kërkesa për transfer mund të realizohet gjatë tërë vitit akademik.

Numri i studentëve që mund të regjistrojnë njësit akademike është në përputhje me planin për regjistrim të studentëve të aprovuar në nivel qëndror.

Pranimin e transferit brenda UBT-së e realizon Komisioni i Transfereve i themeluar nga Dekani.

Komisioni paraqet raportin e transferit, si dhe të njëjtin e nënshkruan.

Shërbimi Studentor në përputhje me Vendimin për Transfer realizon regjistrimin e studentit.

Me vendim të veçant përcaktohet mënyra e llogaritjes së ECTS-vë që studenti duhet t'i realizojë brenda UBT-së.

Poenët e realizuara ECTS pranohen sikur të ishin dhënë në kuadër të programit amë të studimeve, ndërsa, vlera e poenëve të lëndëve i përgjigjet programit të studimeve brenda UBT-së në kuadër të së cilit vijon studimet studentit.

## **IX. KATEGORIZIMI I VEÇANTË I STUDENTËVE**

### **Kategorizimi i sportistëve**

#### **Neni 45.**

Student sportist kategorizohen studentet që kanë arritur rezultate të konsiderueshme sportive dhe arritje renditjeje në garat që organizohen, ose që janë në juridiksionin e federatave dhe komiteteve sportive nacionale, përkatësisht, garat që organizohen dhe mbahen nën patronatin dhe juridiksionin e federatave dhe komiteteve sportive ndërkombëtare që pranojnë nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar.

Të gjitha elementet e nevojshme për kategorizim të sportistëve janë sanksionuar me norma të posaçme që i miraton Këshilli i Komiteti Olimpik i Republikës së Kosovës.

UBT me akte vetjakë normative do të sanksionoi kushtet e përshtatshme studimesh për student të rregullt sportistësh, si në vazhdim:

- **vlerësimin e statusit të sportistit të kategorizuar me rastin e regjistrimit në studime,**
- **përshtatjen e kushteve që kanë të bëjnë lidhur me detyrimin e prezantimit në ligjërrata,**
- **nevojën për caktimin e mentorit ose udhëheqësit,**
- **ndarja e të drejtave të statusit të studentit të rregullt,**
- **sendërtimin e të drejtës për shfrytëzim të mundësisë të pushimit të studimeve,**
- **lejimi i mbajtjes së mësimin nga largësia,**
- **përshkrimin të mënyrës dhe formës të vazhdimin të mëtejshëm të studimeve në rast të ndërprerjes të statusit të studimeve të sportistit të kategorizuar.**

Statusi i kategorizimit të sportistëve përcaktohet me kërkesën e studentit në fillim të vitit akademik me nxjerrjen e aktvendimit mbi kategorizimin ose dokumentit tjetër të nevojshëm.

Dekani i Fakultetit në pajtim me alinenë 2 të këtij neni, lejon mësimin e programit të studimeve nën kushte të përshtatura deri sa studenti arrijë rezultate të domosdoshme suksesi në mësim.

Kushtet e posaçme mund të parashihen në përputhje me specifikat e studimeve të veçanta si dhe nivelin të kategorizimit sportist të studentit.

## **Studentet me sukses të theksuar**

### **Neni 46.**

Student i suksesshëm i theksuar konsiderohet student i cili te gjitha provimet gjatë studimeve i ka dhënë me notë mesatare 9,5 dhe i cili nuk ka përsëritur vitin akademik.

Studentit me sukses të theksuar mund ti lejohet përfundimi i studimeve ne kohëzgjatje me të shkurtër nga koha paraparë për zgjatje të studimeve.

Kushtet e përshpejtimit të avancimit gjatë studimeve përcakton Këshilli i Fakultetit me akt të posaçëm.

## **Studenti mysafirë**

### **Neni 47.**

Student mysafirë konsiderohet student i rregullt ose ai me korrespondencë i cili vjen nga institucionet e larta shkollore nga vendi ose nga jashtë vendit, dhe i cili regjistron pjesë të programit studimor ne studime qe implemetohen në UBT.

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e studentit mysafirë, mënyrë e përmbushjes se detyrimeve financiare dhe çështje tjera lidhur me statusin e studentit mysafirë rregullohet më KONTRATË TË VEÇANTË.

## **X. PËRFUNDIMI I STUDIMEVE**

### **Mënyra e përfundimit të studimeve**

#### **Neni 48.**

Mënyra e përfundimit të studimeve sanksionohet me Ligj dhe programe studimore, si dhe akte normative të “UBT-se”.

### **Arritja e emërtimit profesional dhe akademik si dhe nivelit akademik**

#### **Neni 49.**

Me përfundimin e studimeve konformë kësaj rregulloreje, arrihet emërtimi profesional apo emërtimi akademik ose niveli akademik si dhe të drejta tjera ne pajtim me normat e caktuara.

## **Dokumentet mbi studimet**

### **Neni 50.**

Pas përfundimit të studimeve lëshohet dokumenti (diploma apo certifikata) me të cilin vërtetohet përfundimi i studimeve si dhe arritjen e emërimit profesional apo akademik, respektivisht, nivelit profesional apo akademik adekuat.

Dokumenti nga alineja paraprake trajtohet si DOKUMENT PUBLIK, dhe është i shkruar në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

Përveç dokumentit nga alineja 1 e këtij neni, lëshohet edhe dokumenti plotësues mbi studimet, me të cilin vërtetohet dhënia e provimeve si dhe shënime tjera të nevojshme për kuptim të arritjes së kualifikimit gjegjës profesional apo akademik, si dhe nivelit adekuat.

Forma e Diplomës, Certifikatës ose dokumenteve tjera plotësuesi mbi studimet, përmbajtja e tyre si dhe informacionet tjera përkatëse për bartje të ECTS poenëve, janë të sanksionuar me Ligj dhe akt të brendshme normative të “UBT-se”.

## **XI. KUALITETI I STUDIMEVE**

### **Vlerësimi**

#### **Neni 51.**

Vlerësimi i programeve studimore sigurohet në procedurë vlerësimi konformë Ligjit, si dhe normave tjera ligjore me të cilat rregullohet kualiteti dhe përbërja kualitative dhe e dijes të arsimit të lartë.

UBT me akte të posaçme rregullon vlerësimin e programeve studimore akademike në kuadër të normativave të brendshme të sigurimit dhe ngritjes së kualitetit të “UBT-se”.

## **XII. PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE**

### **Neni 52.**

Përgjegjësit e veprave disiplinore, procedura si dhe masat ndëshkuese rregullohen me akt të posaçëm të “UBT-se”.

## **XIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE**

### **Neni 53.**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje merren në procedurë të njëjtë si dhe vetë Rregullorja.

**Neni 54.**

Kjo Rregullore hynë në fuqi tetë (8) ditë pas nënshkrimit të sajë, si dhe publikimit në Tabelë për Shpallje të “UBT-se”.

**PRISHTINË,**  
**Datë, 15.05 2019**

**BPrAL Kolegji UBT**  
**Presidenti**  
**Prof. Dr. Edmond HAJRIZI**

---